

VENDIM
Nr.549, datë 7.7.2010

PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA PARCELAVE NDËRTIMORE
NË FAVOR TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 17 të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, të shkronjës "ç", të nenit 4, të ligjit nr.7980, datë 27.7.1995 "Për shitblerjen e trojeve", të ndryshuar, dhe të paragrafit të tretë të nenit 175 të ligjit nr.7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kalimit në pronësi të poseduesve të objekteve informale, të sipërfaqeve të parcelave ndërtimore, të zëna, sipas listës dhe planvendosjeve përkatëse, që i bashkëlidhen këtij vendimi, përkatësisht:

a) në qarkun Tiranë, 1925 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 669 294,18 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e nëntëdhjetë e katër presje tetëmbëdhjetë) m²;

b) në qarkun Durrës, 760 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 268 505,66 (dyqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesë presje gjashtëdhjetë e gjashtë) m²;

c) në qarkun Shkodër, 118 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 23 817,44 (njëzet e tre mijë e tetëqind e shtatëmbëdhjetë presje dyzet e katër) m²;

ç) në qarkun Lezhë, 41 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 15 653,62 (pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre presje gjashtëdhjetë e dy) m²;

d) në qarkun Berat, 43 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 14 305,70 (katërmëdhjetë mijë e treqind e pesë presje shtatëdhjetë) m²;

dh) në qarkun Fier, 400 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 100 190,65 (njëqind mijë e njëqind e nëntëdhjetë presje gjashtëdhjetë e pesë) m²;

e) në qarkun Korçë, 18 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 4 630,45 (katër mijë e gjashtëqind e tridhjetë presje dyzet e pesë) m²;

ë) në qarkun Elbasan, 178 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 35 606, 90 (tridhjetë e pesë mijë e gjashtëqind e gjashtë presje nëntëdhjetë) m²;

f) në qarkun Gjirokastrë, 10 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 3 468,40 (tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e tetë presje dyzet) m²;

g) në qarkun Vlorë, 111 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 44 204,90 (dyzet e katër mijë e dyqind e katër presje nëntëdhjetë) m²;

gj) në qarkun Kukës, 13 parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme trualli 3 492,72 (tre mijë e katërqind e nëntëdhjetë e dy presje shtatëdhjetë e dy) m².

2. Ngarkohet Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale për kryerjen e procedurave të kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore të objekteve informale, nga shteti te poseduesi i ndërtimit pa leje.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha